

FJALA E DEPUTETES ENSLEMLVERA ZAKE

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pasiguria është e vetmja gjë e sigurt në këtë vend. Kjo thënie përkufizon më së miri atë po që përjeton ekonomia shqiptare dhe ajo globale në kushtet e një krize të re, atë të rritjes së çmimeve dhe të inflacionit, një rritje që po bashkëshoqërohet nga pasojat ekonomike që kemi pasur, si dhe nga pasojat sociale të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Në kohën kur e gjithë vëmendja jonë ishte përqendruar në amortizimin e pasojave të pandemisë, lufta ruso-ukrainase na vendosi para sfidave të reja, pasojat e së cilës në ekonominë globale janë të rënda, por ende të pamundura për t'u parashikuar.

Sot shpresojmë dhe urojmë që lufta dhe gjakderdhjet të ndalen sa më parë dhe leksionet e pamësuar nga historia të mos marrin më jetë njerëzish. Më vjen keq që në situatën ku ndodhemi tani opozita jo vetëm nuk përpiket t'u shërbejë interesave të popullit, por po vazhdon me avazin e vjetër për destabilizimin e vendit, duke nxitur turmat e njerëzve të protestojnë e të përhapin panik. Këtu kërkoj të më mirëkuptojnë ata qytetarë që protestojnë me shumë të drejtë për të drejtat e tyre, por më vjen keq për ata qytetarë dhe për ata njerëz që u shërbejnë interesave partiake e politike dhe jetojnë të shkëputur nga realiteti. Do të doja shumë që në këtë sallë të dëgjoheshin më tepër diskutime dhe debate konstruktive për mënyrën se di do ta përballojmë këtë krizë, po, për fat të keq, vëmendja e opozitës mbetet te çështje të tjera, që kanë të bëjnë me interesat personale apo partiake.

Të nderuar qytetarë,

Më lejoni t'ju siguroj që qeveria shqiptare po bën maksimumin në mënyrë absolute, duke ndërmarrë masa ekstreme sociale për të mbrojtur çdo konsumator dhe çdo qytetar të kësaj republike. Pse i quajta masa ekstreme? Sepse, po të shikoni të dhënat, mbështetja e qeverisë shqiptare për faturën e energjisë ka kapur vlerën e 500 milionë eurove. Si po menaxhohet dhe po monitorohet kjo krizë? Pa dashur të bie në përsëritje të kolegëve, kriza energjetike po menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme, ndonëse rritja e çmimeve në tregjet botërore dhe mungesa e diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë, pavarësisht rritjes së investimeve, mbeten kërcënim real. Për fat të keq, kriza sapo ka filluar. Thënë kjo, jo për të përhapur panik, po për t'i vendosur të gjithë para përgjegjësisë, masat e ndërmarra janë të përkohshme. Situata do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, si në çdo vend të botës. Para dy ditësh në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ne miratuan dy akte normative tepër të rëndësishme, si pjesë të paketës së rezistencës sociale, që paraqiten sot në parlament për miratim: ai i rishikimit të buxhetit të vitit 2022, si dhe ai i ndryshimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", në fokus të të cilave janë shtresat në nevojë.

Synimi kryesor i rishikimit të buxhetit të vitit 2022 është financimi i një fondi kontigjence për paketën e rezistencës sociale prej 6 miliardë lekësh, që do të përdoret për zbutjen e pasojave të krizës, në mbështetje të shtresave në nevojë, sektorit të transportit publik dhe sektorit të bujqësisë. Konkretisht, 3,3 miliardë lekë shkojnë për indeksimin e pensioneve, ku përfitojnë 673 542 qytetarë; kompensim i rritjes së çmimeve të shportës me 3000 lekë në muaj për tre muaj me 576 mijë përfitues; 1,45 miliardë lekë mbështetje për fermerët me naftën pa taksa; 500 milionë lekë mbështetje për të gjithë qytetarët që përdorin linjat urbane, qytetase dhe ndërqytetëse; plus 28 miliardë lekë financim i mburojës së çmimit të energjisë për konsumatorët familjarë dhe biznesin e vogël.

Gjithashtu, rishikimi i buxhetit synon mbështetjen e sektorit të energjisë prej 20 miliardë lekësh, si dhe reflektimin e ndryshimeve në kahun e të ardhurave, i cili ka pësuar rritje në masën 10 miliardë lekë, si rezultat i performancës pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore për dy muajt e parë të vitit 2022. Me aktin normativ për ndryshimin e buxhetit janë reflektuar shkurtimet e zërave të shpenzimeve korrente për të gjitha institucionet buxhetore në masën 5,8 miliardë lekë, shkurtim i projekteve me financim të brendshëm në masën rreth 5,2 miliardë lekë, si dhe shkurtim i përgjithshëm i projekteve me financim të huaj në masën 4,6 miliardë lekë. Vlen të theksohet fakti se këto ndryshime nuk impaktojnë deficitin buxhetor. Për sa i takon aktin normativ “Për një ndryshim në ligjin nr. 113/2021 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, avancohet zbatimi i pasqyrës 1, të parashikuar me këtë ligj, nga data 1 korrik në 1 prill 2022. Pra, nga data 1 prill 2022 rritet paga dysHEME e patatueshme, nga 30 000 lekë në muaj që është aktualisht, në 40 000 lekë në muaj.

Nga ky ndryshim përfitojnë 71 500 qytetarë. Shuma e përfitimit është mesatarisht 7 800 lekë në vit për çdo qytetar. Gjithashtu, reduktohet norma tatimore me 50% për tatimpaguesit me të ardhura të pagave nga 40 001 lekë/muaj deri në 50 000 lekë/muaj. Nga ky ndryshim përfitojnë rreth 58 000 tatimpagues, me një shumë përfitimi rreth 11 700 lekë mesatarisht për tatimpagues në vit. Në të njëjtën linjë, mbështetja vazhdon edhe për shtresat e mesme, duke rishikuar fashën e sipërme të tatimit progresiv. Tatimi 23 % parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200 000 leke në muaj, nga 150 000 lekë në muaj që është aktualisht. Numri i përfituesve nga ky ndryshim është rreth 5 900 tatimpagues, ndërsa shuma e përfitimit është mesatarisht 23 000 lekë për tatimpagues në vit.

Këto masa synojnë të lehtësojnë kryesisht shtresën e ulët dhe atë të mesme, duke i qëndruar fort parimit të progresivitetit, ku ai që fiton më shumë, paguan më shumë. Për ta përmbyllur, situata aktuale e krijuar dikton vëmendje të shtuar në politikat ekonomike, tregtare, monetare e financiare, si dhe ato të menaxhimit të rezervave. Prandaj, kolegë deputetë, ju ftoj t’i miratojmë këto dy akte normative, të cilat u vijnë në ndihmë kryesisht qytetarëve. Ju faleminderit!